

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti Për Krimeve Të Rënda, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit Xh.K., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.I.nr.565/2016 të datës 31.10.2016, pas shqyrtimit fillestar me datë 16.12.2016 në të cilën morën pjesë Prokurori i Shtetit Kujtim Munishi, i pandehuri Xh.K., si dhe mbrojtësi av B.E. sipas autorizimit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: Xh. K., i biri i U. dhe F., e gjinisë S., i lindur me dt *data e lindjes...*, në fshatin M., KK P., ku edhe jeton, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar baba i tre fëmijëve, bashkëpronar në depon “ANGJ S.”, me seli në P., me numër personal *numër personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: Me datë 18.10.2016 rreth orës 12:53 h, në Prishtinë në rrugën “Tirana”, i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm me armët, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrit- revolen e tipit “Cervena Zastava”, me numër serik 10367, me numër serik 10367, me një karikator dhe 12 fishekë si dhe një brisk, e që pas kontrollit nga pjesëtarët e policisë së Kosovës janë gjetur dhe sekuestruar dëshmitë e lartcekura.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së.

Andaj gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur, neneve 7,17,21,41,43,46,73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK –së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit **XH.K.**, i caktohet dënim në gjobë në shumë prej **500 € (pesëqind euro)**, në afatin prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do të zëvendësoj dënim në gjobë në dënim me burgim, ashtu që një ditë burgimi do t'i llogaritet me 20 € gjobë.

Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedure penale, dhe atë paushallin gjyqësorë në shumën prej **50 (pesëdhjetë) euro**, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Komfor nenit 115 të KPPK-së konfiskohet:

Armën e zjarrit- revolen e tipit “Cervena Zastava”, me numër serik 10367, me numër serik 10367, me një karikator dhe 12 fishekë si dhe një brisk.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.565/2016 të datës 31.10.2016, me të cilën ka akuzuar të pandehurin Xh.K., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së.

Me datë 16.12.2016 Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë qështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën PP.I.nr.565/2016 të datës 31.10.2016, ndërsa Kryetari I Trupit Gjykues pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform nenit 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

Prokurori i çështjes në shqyrtimin e datës 16.12.2016 në Gjykatë ka paraqitur marrëveshjen për pranimin e fajësisë, njoftimin si dhe deklaratën e të pandehurit në pajtim me nenin 233 të KPRK-së, dhe i njëjti mes tjerash ka theksuar se: se Prokuroria Themelore në Prishtinë Departamenti I Krimeve të Rënda me dt. 26.10.2016 në bazë të nenit 233 të KPPRK-së ka negociuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë me të pandehurin Xh.K., I cili akuzohet për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së. Pas negociimit për marrëveshjen e pranimit të fajësisë I pandehuri e ka pranuar fajësinë për gjitha pikat e akuzës dhe me të pandehurin janë pajtuar në tërësi sa I përket kësaj marrëveshje, I rekomandojë Gjykatës që për veprën penale në fjalë sipas marrëveshjes së paraparë dënimin me gjobë prej 400 € deri në 600 € duke i lënë në diskrecion Gjykatës që të vendos. Njëkosisht në bazë të nenit 374/3 dhe nenit 69/1 të KPKR-së kundër të pandehurit Xh. K. si dënim plotësues I rekomandojë Gjykatës edhe konfiskimin e armës “Cërvena Zastava” me numër serik 10367 dhe një karikator dhe 12 fishek, si dhe një brisk. Të pandehurin e ka njoftuar se deri në fund të shqyrtimit kryesor pas negociimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë ekziston e drejta për ta refuzuar këtë marrëveshje gjë që I pandehuri ishte pajtuar për të gjitha pikat e akuzës, dhe I propozojë Gjykatës që marrëveshjen në fjalë ta pranojë në tërësi dhe të pandehurin ta shpall fajtores ashtu siç janë pajtuar.

Mbrojtësi i të pandehurit Xh. K.- av B. E., lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë ka deklaruar se: pajtohet me deklarinimin e prokurorin të çështjes lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë për këtë qështje penale-juridike dhe e lut Gjykatën që këtë marrëveshje ta aprovojë në tërësi në momentin e matjes së dënimit të marr si rrethana lehtësuese faktin se Xh. K. më parë nuk ka ra në ndesh me ligjin, se është penduar thell për këtë vepër penale, pendimi I tij i sinqertë, dhe është garancë e fortë se në të ardhmen nuk do të kryej vepër penale, I propozojë Gjykatës që të shqiptojë minimumin e dënimit se edhe me minimum do të arrihet qëllimi I dënimit në bazë të nenit 41 të KPKR-së.

I pandehuri Xh. K., mes tjerash deklarojë: *se jam penduar për kryerjen e veprës penale, i njëjti i premtojë Gjykatës se më nuk do të përsërisë vepra penale.*

Gjykata pas dëgjimit të palëve në procedurë, duke konstatuar se janë plotësuar kriteret nga neni 233/18 të KPPRK-së, mori aktvendim ku pranojë marrëveshjen për pranimin e fajësisë me numër PPI.nr.565/2016 e dt. 26.10.2016, dhe të pandehurit atë në shumë prej 500 €.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë, pendesën e shprehur nga ana e të pandehurit, premtimin se më nuk do të përsërisë vepra penale, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoj një dënim në gjobë, duke marrë parasysh shkallën e

përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimin ndëshkimorë në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimorë në kuptim të preventivës gjenerale që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor komfor nenit 115 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenit 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR.nr 642/16, datë 16.12.2016

Sekretarja Juridike:
Shqipe Rexhepi

Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.